



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

PA 1 Nr.08-211

04.11.2022

Shkup

Këshilli i Agjencis për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 2, neni 20 paragrafi (1) alinea 10¹, dhe në lidhje me nenin 76 paragrafi (7) dhe neni 24 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20 dhe 77/21), neni 15 paragrafi (1) alinea 2, neni 39 paragrafi (1) alinea 10 dhe neni 51 paragrafi (3) i Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019 dhe neni 10 i Rregullores për zonat e transmetimit të shërbimeve programore televizive dhe radio, ark.nr.01-5778/1 datë 21.11.2014 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.172/14), në lidhje me Kërkesën e dorëzuar për dhënie të lejes pa shpallje të konkursit publik për transmetim televiziv, në nivel lokal, (PA1 nr.08-211 datë 12.7.2022, me plotësime (ndryshime) nga 30.8.2022 dhe nga 4.10.2022,) nga personi fizik Amir Hamiti nga ...dhe Konkluzioni ark.nr.02-4013/2 datë 3.11.2022, në seancën e 41-të të mbajtur më 3.11.2022, miratoi si vijon:

VENDIM

për dhënie të lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar në nivel lokal

1. I NDAHET leja për transmetim televiziv të servisit programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën shqipe, në nivel lokal në zonën e Komunës së Kumanovës, Komunës së Likovës dhe Komunës së Staro Nagoriçit, personit fizik Amir Hamiti nga ..., me NVAQ ...

Shërbimi programor televiziv nga paragrafi (1) i kësaj pike do të transmetohet përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar.

2. Leja nga pika 1. e këtij Vendimi, ndahet për një periudhë 9 (nëntë) vjeçare.

3. Pas pranimit të këtij Vendimi për dhënien e lejes, personi fizik Amir Hamiti nga ..., të cilit i është dhëna leja nga pika 1. e këtij Vendimi, duhet të regjistrojë Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive në regjistrin përkatës pra në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga personi fizik Amir Hamiti nga ..., të cilit i është dhënë leja nga pika 1. e këtij Vendimi, do të paguajë një tarifë vjetore në llogarinë e Agjencisë, për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes në afat brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së lëshuar nga Agjencia.

5. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga personi fizik Amir Hamiti nga ..., të cilit i është dhënë leja nga pika 1 e këtij Vendimi, detyrohet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë më datë 1.12.2022.

Në rast të mosrespektimit të afatit për fillimin (ushtrimin) e veprimtarisë nga paragrafi 1 i kësaj pike të Vendimit, Agjencia do të revokojë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilin është dhënë dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

6. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

¹ Alinet 8 dhe 9 fshihen, shiko: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 76 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), jep leje për transmetim televiziv ose radio nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar ose nëpërmjet satelitit, për të cilin nuk shpallet konkurs publik, dhe leja jepet me kërkesë të palës së interesuar sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar me Ligjin e lartpërmendur.

Personi fizik Amir Hamiti nga ...më 12.7.2022. drejtuar Agjencisë ka paraqitur Kërkesë për dhënie të lejes pa shpalljen e konkursit publik PA1 nr.08-211, për transmetimin televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën shqipe, në nivel lokal në zonën e Komunës së Kumanovës, e cila do të transmetohet përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse (burime) të kufizuara.

Pas pranimit (marrjes) së Kërkesës për dhënien e lejes pa shpallur konkurs publik për transmetim televiziv, PA1 nr.08-211 datë 12.7.2022., shërbimi profesional i Agjencisë vazhdoi me shqyrtimin e së njëjtës dhe ka konstatuar se kërkesa e paraqitur nuk është e plotësuar siç duhet, kërkesa nuk përmban të dhënat e duhura të parashikuara në nenin 76 paragrafët (3) dhe (4) nga LSHMAAV, d.m.th. nuk është e plotë. Për sa më sipër, Agjencia në pajtim me nenin 76 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, më 9.8.2022., me shkresë – Njoftim, PA1 nr.08-211 datë 9.8.2022., ka njoftuar aplikuesin e kërkesës – personin fizik Amir Hamiti që detyrohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së njoftimit të plotësojë kërkesën në fjalë dhe të mënjanojë mangësitë e konstatuara. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit të caktuar nga Agjencia, pra më 30.8.2022. ka paraqitur ndryshim në Kërkesë PA1 nr.08-211 datë 30.8.2022., për dhënien e lejes pa shpallur konkurs publik për transmetim televiziv. Pas shqyrtimit, shërbimi profesional i Agjencisë ka konstatuar se sërish ka disa mangësi, në lidhje me të cilën parashtruesit të kërkesës i është dërguar Shkresë-Njoftim PA1 nr.08-211 datë 16.9.2022., me të cilën është njoftuar që të mënjanojë mangësitë dhe obligohet në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, të plotësojë Kërkesën për dhënien e lejes pa shpallur konkurs publik (PA1 nr.08-211 datë 12.7.2022. me plotësim datë 30.8.2022.). Më 4.10.2022., parashtruesi i kërkesës, personi fizik Amir Hamiti, sërish ka dorëzuar në Agjenci n Kërkesën PA1 nr.08-211 me ndryshime, për dhënien e lejes pa shpallje të konkursit publik për transmetim televiziv. Pas shqyrtimit të saj, u konstatua se e njëjta është në rregull dhe e plotë.

Për të vërtetuar saktë faktet për marrjen e vendimit për dhënien e lejes për transmetim televiziv, gjegjësisht për të përcaktuar se në cilat Shoqëri Tregtare paraqitet si themelues/pronar ose drejtues personi fizik Amir Hamiti nga ..., më 18.10.2022. përmes sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrin Qendror të RMV-së, Agjencia ka ofruar „Informacion për subjektet që ndërlidhet (persona të autorizuar, organe drejtuese, pronarë në subjekte të tjera – gjendje vijuese“, ark.nr.0818-50/150020220267191 datë 18.10.2022. (Nr.yni.ark.03-3858/1 datë 18.10.2022.), ku është konstatuar se nuk janë shkelur dispozitat e kreut IV të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pas shqyrtimit të Kërkesës së paraqitur për dhënien e lejes pa shpallur konkurs publik për transmetim televiziv, PA1 nr.08-211 datë 12.7.2022., me plotësimet e datës 30.8.2022. dhe datë 4.10.2022., në pajtim me nenin 76 paragrafi (7) të LSHMAAV, u përcaktua se aplikanti në fjalë i përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe kërkuesit personit fizik Amir Hamiti nga ..., nuk i është hequr leja për transmetim televiziv ose radio në 5 (pesë) vitet e fundit.

Në pajtim me nenin 76 paragrafi (7) të LSHMAAV, Agjencia do të marrë vendim për dhënien e lejes brenda tre muajve nga dita e pranimit të rregullt të kërkesës, nëse konstaton se aplikanti i përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me këtë ligj dhe rregulloret e miratuara bazuar në ligj dhe nëse kërkuesit nuk i është hequr leja për transmetim televiziv dhe radio.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, personi i autorizuar, (sipas) në pajtim me Autorizimin, ark.nr.03-3556/1 datë 28.9.2022. dhënë nga drejtori i Agjencisë, drejtuar Këshillit të Agjencisë ka dorëzuar Propozim PA1 nr.08-211 datë 1.11.2022. për miratim Vendim për dhënie të lejes për transmetim televiziv.

Pas pranimit të këtij Vendimi për dhënie të lejes, personi fizik Amir Hamiti nga ..., të cilit i është dhënë leja nga pika 1. e këtij Vendimi, duhet të regjistroj Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive në regjistrin përkatës pra në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë

së Veriut. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga personi fizik Amir Hamiti nga ..., të cilit i është dhënë leja nga pika 1. e këtij Vendimi, do të paguajë tarifë vjetore në llogarinë e Agjencisë, për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të faturës së lëshuar (dhënë) nga Agjencia. Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së tarifës për lejen për transmetim televiziv sipas kërkesës nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs (burim) të kufizuar, përcaktohet nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 80 të Ligjit të lartpërmendur dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e veprimtarisë financiare dhe kontabël të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga personi fizik Amir Hamiti nga ..., të cilit i është leja nga pika 1. e këtij Vendimi, detyrohet të fillojë ushtrimin (kryerjen) e veprimtarisë më datë 1.12.2022., dhe nëse poseduesi i lejes nuk fillon të ushtrojë veprimtarinë brenda afatit të përcaktuar në leje, Agjencia në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) alineë 1 nga LSHMAAV, do t'ia marrë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilin është dhënë dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

Bazuar në sa më lartë, Këshilli i Agjencisë në seancën e 41-të, mbajtur më 3.11.2022, dhe në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4013/2 datë 3.11.2022., miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

Përpiloi: mr. Biljana Paneva-Parleeva

Kontrolluan: dr. Andriana Skerlev-Çakar, mr. Ivona Mufisheva

Miratuan: Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, mr. Arben Saiti, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva

Në pajtim: mr. Dragica Ljubevska

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi Kërkuesi (aplikanti) për dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik, nëse është i pakënaqur me vendimin, mund të ngrejë padi para gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Një kopje e vendimit t'i dorëzohet:

- Personit fizik Amir Hamiti nga Kumanova;
- Drejtorit të Agjencisë,
- Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë;
- Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, dhe
- Personat e emëruar për udhëheqjen e Regjistrin (PA1).